



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezuar Primitioj / Prodato Received / Delivered	28.07.2022	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPH/SH/CH	4393/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.529/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.529/2022 të datës 14.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër Vendimit me Nr.388 të datës 12.05.2022 të Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.529/2022 e datës 14.06.2022 e parashtruar nga ankuesi.
- II. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme që të zhvilloj procedure të re të rekrutimit/lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *Inspektor për Infrastrukturë Kritike*.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, Zyrtar për të Huaj në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 10.06.2022 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë më datë 14.06.2022 është pranuar dhe regjistruar me numër protokolli 3451/2022 dhe shenjën A.nr.529/2022, kundër Vendimit me Nr.388 të datës 12.05.2022 të Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 16.06.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli më datë 23.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me Nr. Prot:3451/2022 të datës 14.06.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.388 të datës 12.05.2022 të Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Emailin e datës 01.06.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 12.05.2022 nga për ankuesin; Vendimin me Nr. 358 i datës 28.04.2022 nga Menaxheri i Personelit; Njoftimin e datës 29.04.2022; Emailin e datës 29.04.2022, 22.04.2022 nga SIMBNJ; Vërtetimin e datës 22.04.2022; Vendimin me Nr. 236 i datës 28.03.2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i 08.02.2022, 19.02.2021; Certifikatën 11-12.06.2018; Certifikatën 22-23.11.2021; Certifikatën 17-18.03.2011; Certifikatën 21-22.02.2011; Certifikatën e datës 03.11.2009; Certifikatën shtator 2009; Certifikatën me Nr. 4375/10 nga The Cambridge School e datës 31.03.2010; Certifikatën me Nr. 3284/09 nga The Cambridge School e datës 15.12.2009; Kontrate e marrëdhënies së punës me Nr. 19/2010; Akt Emërimit e datës 31.01.2013; Referencës me Nr. 08.09 e datës 11.09.2009; Diplomën në emër të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.06.2022; Përgjigje në ankesë e datës 23.06.2022; Konkursin për lëvizje brenda kategorisë me Nr. Reference RN00008665 i datës 31.03.2022 për pozitën Inspektor për Infrastrukturë Kritike; Vendimin me Nr. 445 i datës 23.03.2022; Lista e aplikantëve; Aplikacionin e ankuesit; Ankesën e ankuesit; Emailin e datës 12.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, *sepse:*

Nga provat e lëndës rezulton se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 14.04.2022 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), ka hapur Konkurs për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *Inspektor për Infrastrukturë Kritike* me numër *reference RN00008665*.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi (Aplikacioni - RAN0004317), mirëpo nga shkresat e administruara të lëndës del se të njëjtit me Vendimin Nr.358 të datës 28.04.2022 të Menaxherit të Personelit, i është refuzuar aplikacioni për shkak të mosplotësimit të kushteve të konkursit, respektivisht kriterit për njohje të gjuhës angleze, dhe si rrjedhojë organi i punësimit, gjegjësisht

Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 29.04.2022 ka publikuar njoftimin për ndërprerjen e procedurës përkatëse të rekrutimit me arsyetimin se nuk është identifikuar të paketën një kandidat që i plotëson kriteret e konkursit.

Ankuesi, kundër Vendimit Nr.358 të datës 28.04.2022 dhe Njoftimit të datës 29.04.2022, për ndërprerje të procedurës së rekrutimit, ka parashtruar ankesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPB-së. Kjo e fundit me Vendimin Nr.388 të datës 12.05.2022 ka hedhur poshtë si të pabazuar ankesën e ankuesit

Kundër Vendimit Nr.388 të datës 12.05.2022 të Menaxherit të Personelit të MPB-së, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi për refuzimin e ankesës nuk është i mbështetur në asnjë provë të vetme dhe mbështetëse për faktin se në Konkursin e shpallur me datë 31.03.2022 për pozitën *Inspektor për Infrastrukturë Kritike* me numër *reference RN00008665*, në piken 3 është kërkuar njohja e gjuhës angleze (e obligueshme) mirëpo nuk është përcaktuar niveli i njohjes së gjuhës angleze. Me tutje i njëjti, pretendon se vendimit të kontestuar i mungon pjesa përmbyllës, dhe ajo arsyetuese, ndërsa dispozitivi sipas ankuesit është i paqartë dhe mungesa e këtyre elementeve e bënë këtë vendim të paefektshëm, andaj kërkon që të anulohet Vendimi Nr.388 i datës 12.05.2022 dhe të obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që të vazhdoj me procedurat e rekrutimit për pozitën *Inspektor për Infrastrukturë Kritike/MPB*.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar shkresat e lëndës, përkatësisht Konkursin për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *Inspektor për Infrastrukturë Kritike* me numër *reference RN00008665* të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme, dhe rrjedhimisht ka gjetur se në pikën 3 të këtij konkursit janë përcaktuar kërkesat e përgjithshme formale: 1. *Diplomë universitare: Fakulteti Juridike, më të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjta apo vazhdim specializim i Diplomës Bachelor; 2. Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale; dhe 3. Njohja e gjuhës angleze (e domosdoshme), ndërsa në piken 5 janë përcaktuar dokumentet që duhet të paraqiten për aplikim: Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; Kopjet e dëshmisë së punësimit; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve; Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit; Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.*

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, përkatësisht nenin 8 të këtij ligji, janë përcaktuar kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë, ndërsa me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 18 përcaktohet se: 1. *Kërkesat e përgjithshme formale, janë kushte formale që duhet të plotësojë personi për të pasur të drejtën për të konkuruar në pranimin apo avancimin në karrierë në shërbimin civil. Plotësimi i këtyre kërkesave bën të supozohet se personi zotëron njohuritë, aftësitë dhe cilësitë bazike për kryerjen me sukses të detyrave të pozitës përkatëse. 2. Kërkesat e përgjithshme formale janë kërkesat për zotërimin e arsimit që përfshin nivelin dhe fushën e arsimit, kualifikimin apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për atë pozitë përkatëse (psh. proviminin e jurisprudencës apo ndonjë certifikim tjetër), përvojës profesionale domethënëse në profesion dhe/apo në punë apo kushteve të tjera specifike (psh.*

zotërimi një certifikimi për një gjuhë të huaj, etj.). 3. Verifikimi i plotësimit të tyre në bazë të dokumentacionit të paraqitur apo vetëdeklarimit të kandidatëve, është hapi i parë fazë e verifikimit paraprak në procedurën e pranimit apo ngritjes (avancimit) në karrierë në shërbimin civil të Kosovë.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore vlerëson se organi i punësimit me rastin e shpalljes se procedurës se rekrutimit (pranim, lëvizje paralele apo ngritje në detyre) duhet t'i specifikoj dokumentet të cilat duhet të dorëzohen me qëllim të verifikimit të plotësimit të kushteve të përgjithshme formale. Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit vlerëson se organi i punësimit, gjegjësisht Ministria e Punëve të Brendshme, me rastin e shpalljes se Konkursit për pozitën e punës *Inspektor për Infrastrukturë Kritike* me numër *reference RN00008665*, nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore, sepse për pozitën e punës për të cilat kërkohet edhe njohja e ndonjë gjuhë të huaj, në shpallje të konkursit duhet të përcaktohet standardi, respektivisht niveli i njohjes se gjuhës në mënyrë që në fazën e verifikimit paraprak të dokumentacionit të bëhet vlerësimi i plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta duke ju referuar kriterëve të konkursit.

Andaj, meqenëse në shpallje të konkursit nuk është përcaktuar standardi, respektivisht niveli i njohjes se gjuhës angleze, Kolegji i Këshillit vlerëson se shpallja e konkursit përmban të meta ligjore në aspektin e përcaktimit të kushteve formale, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar. Ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me detyrimin e organit të punësimit për vazhdimin e procedurës se rekrutimit sipas kësaj shpallje është i pa bazuar për shkak të metave ligjore të konstatuara si më lartë.

Kolegji i Këshillit bazuar në të gjeturat dhe konstatimet e pasqyruara si më lartë thekson faktin se Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme obligohet që të zhvilloj procedure të re të rekrutimit "Lëvizje brenda kategorisë" për pozitën e punës *Inspektor për Infrastrukturë Kritike* në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pasi që Kolegji ka konstatuar se për shkak të metave ligjore në aspektin e përcaktimit të kushteve formale në konkursin e kontestuar në këtë ankesë vlerësohet se nuk janë konsumuar veprimet formale nga neni 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratet Publikë ku përcaktohet se: "Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë", respektivisht Kolegji i Këshillit vlerëson se pa u përsëritur apo rishpallur konkursi për lëvizje brenda kategorisë, institucioni nuk mundet të vazhdoj tutje me procedurat e ngritjes në detyrë ta parashikuara sipas nenit 39 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratet Publikë.

Kolegji i Këshillit, po ashtu, njëzëri konstaton se Ministria e Punëve të Brendshme me rastin e përsëritje së konkursit "Lëvizje brenda kategorisë" për pozitën e punës *Inspektor për Infrastrukturë Kritike*, apo me rastin e rekrutimit të pozitave të caktuara për të cilat kërkohet edhe njohja e gjuhës angleze ose ndonjë gjuhë tjetër të huaj, duhet të përcaktojë specifika të qarta të nivelit të njohjes së gjuhës së huaj dhe përveç kësaj duhet të përcaktojë po ashtu autoritetin që vlerëson nivelin e njohjes së gjuhës së huaj për kandidatët në procedurë, sikurse duhet të përcaktohen kërkesat e veçanta për pozitën e lirë referuar nenit 41 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcakton se: "Kërkesat e

veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurrim për lëvizjen brenda kategorisë”, duke iu referuar shpalljes së konkurrimit të lëvizjes brenda kategorisë siç parashihet me nenin 43 të kësaj rregulloreje.

Kështu që duke marr parasysh të gjitha shkresat dhe provat e bashkëngjitura të lëndë, dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.529/2022

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshmes; dhe
- Arkivoit të KPMSHCK-së.

